



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**AC-II-23-0030**

***Në propozimin për përsëritje të procedurës***

***Paditësi/Parashtruesi i propozimit***

**Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra Regjionale Mitrovicë - Autoriteti i Likuidimit i NSHBQ "Drenica", Drensa-Gllogoc.**

***Kundër***

***I padituri***

**M K** nga fshati T, i përfaqësuar nga avokati Xh B, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me propozimin për përsëritje të procedurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gllogoc, C.nr.31/07 të datës 24 shtator 2007, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Propozimi i AKP-së për përsëritje të procedurës kontestimore, të paraqitur kundër Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Gllogoc, C.nr.31/07 të datës 24 shtator 2007, refuzohet si i pa bazuar.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore lidhur me procedurën sipas propozimit për përsëritje të procedurës.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 05 tetor 2006, paditësi M (T) K / në këtë lëndë i padituri ,e ka dorëzuar në DHPGJS një padi pronësore dhe kërkon nga Gjykata të vërtetohet e drejta e tij e pronësisë për ngastrën kadastrale Nr..., në vendin e quajtur "L", kulturë arë e klasit të pestë, në sipërfaqe prej 5,96.22 ha, e evidentuar në fletën poseduese Nr..., ZK T, dhe të detyrohet NSH-ja e paditur Ndërmarrja prodhuese bujqësore qarkulluese "Drenica", Gllogoc që të pranojë të drejtën e pronësisë dhe të lejojë regjistrimin e kësaj të drejtë në regjistrin kadastral. Paditësi në këtë padi ka pohuar se prona në fjalë është pasuri e tij, që e ka trashëgim prej paraardhësve të tij e cila i është marrë në vitin 1952, ndërsa në vitin 1964, kjo pronë është blerë nga M D nga Ç e R, të cilën pasuri i është bashkangjitur pasurisë së të paditurit, ndërsa e paditura e ka dhënë këtë ngastër, mirëpo në Librat kadastral nuk është bërë përmisimi, dhe sot e kësaj dite ajo ka mbetur e evidentuar në emër të NSH-së së paditur. Paditësi këtë padi e mbështet në Konfirmimin me shkrim Nr.49 të datës 29 maj 2006, të lëshuar nga NSH e paditur. Bashkë me këtë padi ai ka dorëzuar Autorizimin e avokatit, Njoftimin për qëllimin e paraqitjes së padisë në DHPGJS dërguar AKM-së, me datë 06 korrik 2006, Ekstraktin nga fletë posedimi, Nr.952/309, të datës 29 maj 2006, dhe Konfirmimin e lëshuar nga NSH "Drenica", Nr.49, të datës 29 maj 2006.

Trupi gjykues i DHPGJS me Aktvendimin SCC-06-0439, të datës 31 janar 2007 padinë e përcjellë në kompetencë të Gjykatës Komunale në Gllogoc, ndërsa vendos që në rast ankesë, ankesa duhet të dorëzohet pranë DHPGJS-së.

Dosja e lëndës e dërguar në Gjykatën Komunale në Gllogoc regjistrohet me numrin C.nr.31/07.

Gjykata Komunale në Gllogoc i ka mbajtur disa seanca të shqyrtimit kryesor lidhur me padinë. Seanca e fundit e shqyrtimit kryesor është mbajtur me datë 24 shtator 2007. Në bazë të procesverbalit të seancës vërehet se për paditësin ka marrë pjesë M K, për të paditurën Kooperativa Bujqësore "Gllogoci" në Gllogoc,

respektivisht përfaqësuesit e këtyre palëve, avokati Xh B për paditësin dhe i autorizuari i NSH-së sipas autorizimit me shkrim H G. Në bazë të procesverbalit të kësaj seance gjyqësore vërehet se janë administruar të gjitha provat që i kanë sjellë palët në procedurë, e është lexuar edhe ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë F T, në pjesën tekstuale dhe atë skicore. Në bazë të procesverbalit të kësaj seance vërehet se i autorizuari i paditësit ka mbetur pranë të gjitha theksimeve në padinë e tij, duke kërkuar që të vërtetohet e drejta e pronësisë së paditësit për ngastrën lëndore. I autorizuari i NSH-së së paditur në fjalën përfundimtare ka pohuar se NSH-ja për asnjë moment nuk e ka pasur në shfrytëzim dhe posedim ngastrën lëndore, ai pohon se nuk e kemi kontestuar faktin se kjo paluajtshmëri është e paditësit, e duke u bazuar edhe në atë se paditësi e kishte blerë paluajtshmërinë gjatë vitit 1964 në KK Sh dhe Ç e Re, me qëllim që atë pasuri ta ndërrojë me pasurinë që tani është objekt shqyrtimi, dhe në tërësi e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit.

Me datë 24 shtator 2007, Gjykata Komunale në Glllogoc, me pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit C.nr.31/07 e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe vërteton se paditësi M (T) K është pronar faktik i ngastrës kadastrale Nr..., në vendin e quajtur "LL" me kulturë arë, klasa e pestë, me sipërfaqe prej 5,96.22 ha, e evidentuar në emër të pasurisë shoqërore, Kooperativës Bujqësore "Glllogoci" në Glllogoc, evidentuar sipas fletës poseduese Nr..., Zona Kadastrale në T. Me pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit detyrohet e paditura që t'ia njeh paditësit të drejtën në pronësi e posedim dhe ti mundësojë regjistrimin e ngastrës në Librat publik kadastral, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Gjykata Komunale në Glllogoc, në arsyetimin e Aktgjykimit të ankimuar përshkruan të gjitha veprimet e ndërmarrura dhe provat e administruara gjatë procedurës në Shkallën e I-rë, si dhe ka dhënë dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar. Tutje Gjykata Komunale në Glllogoc nxjerrë konstatimin se paditësi ngastrën lëndore e ka trashëguar nga paraardhësi i tij, i ati T K, i cili ishte shtëpiak i pasur në T e Drenicë dhe se kur shteti i atëhershëm e kishte halë në sy si familje kullake, sikurse edhe disa familje tjera të cilëve u ishte marrë paluajtshmëritë mbi 10 ha, ndërsa paraardhësit të paditësit i ishte marrë

paluajtshmëria më tepër se 15 ha tokë buke. Këto fakte janë vërtetuar nga dëshmitarët e dëgjuar se paditësi kishte shitur paluajtshmërinë me kulturë pyll në vendin e quajtur "M i R", në T dhe kishte blerë paluajtshmërinë në Zonat Kadastrale Sh e Ç e R, do të thotë atje ku e paditura e kishte paluajtshmërinë, me kusht që paluajtshmëritë e blera ti ndërronte me paluajtshmëritë e të paditurit. Paluajtshmëritë e blera përmes ndërrimit duhej të merrte e paditura, si pasuri e tij e marrur nga pushteti i atëhershëm e në afërsi të shtëpisë së tij ku ishte edhe ngastra Nr.... Tutje Gjykata Komunale në Glllogoc konstaton se paditësi ngastrën kontestuese, e kishte në pronësi faktike e në shfrytëzim e posedim të papenguar që nga viti 1964, ngase kjo paluajtshmëri ishte e veçuar dhe në të gjitha anët e kufizuar me gardh të bimë, dhe si e tillë edhe nga oborri i shtëpisë së paditësit të cilën e ndante vetëm një rrugë publike, prova këto që arsyetojnë aprovimin e padisë së paditësit. Tutje Gjykata Komunale në Glllogoc këtë Aktgjykim e mbështet në nenin 28 paragrafi 4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore, duke konstatuar se kjo paluajtshmëri është në posedim dhe shfrytëzim me mirëbesim më shumë se 40 vite nga ana e paditësit, dhe se ai e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues.

Në bazë të fletë dorëzimeve që ekzistojnë në dosje paditësi e ka pranuar Aktgjykimin me datë 01.11.2007, ndërsa përfaqësuesi i të paditurës H G me datë 30.10.2007.

Në bazë të evidencës së Zyrës së Regjistrimit të DHPGJS-së, asnjëra palë nuk ka paraqitur ankesë ndaj Aktgjyimit të Gjykatës Komunale në Glllogoc. Rrjedhimisht në bazë të këtij fakti, ky Aktgjykim është bërë i formës së prerë, që nga data 26.02.2008.

Me datë 28 korrik 2023, AKP-ja – Zyra Regjionale në Mitrovicë – Autoriteti i Likuidimit i NSH BQ "Drenica", në Glllogoc, e dorëzon në DHPGJS një Propozim për përsëritje të procedurës të paraqitur kundër Aktgjyimit të Gjykatës Komunale në Glllogoc, C.nr.31/07, të datës 24 shtator 2007, i cili tashmë është i formës së prerë që nga data 26.02.2008. Në këtë propozim AKP-ja ka pohuar se me

Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Glllogoc, C.nr.31/07, të datës 24 shtator 2007 i është njohur paditësit e drejta e pronësisë për ngastrën kadastrale Nr..., në sipërfaqe prej 5,96.22 ha, në vendin e quajtur "LL", e cila evidentohet në emër të paditurës, PSH Kooperativa Bujqësore "Glllogoc". Tutje në këtë Propozim AKP-ja pohon se i ka dërguar një kërkesë Drejtorisë Komunale të Kadastrit në Glllogoc për të dhënë informata për ngastrën Nr..., ZK T, se a është kjo ngastër në komasacion apo jo, dhe çdo informatë tjetër. AKP-ja pohon se në vitin 2014, Drejtoria e Kadastrit e Glllogovcit e ka informuar AKP-në që të gjitha parcelat shoqërore në T, janë në komasacion dhe nuk lëshojnë certifikata deri në përfundimin e komasacionit. Tutje në këtë Propozim AKP-ja pohon se me datë 16.05.2023, Drejtoria Kadastrale e Glllogovcit i ka dërguar një email zyrtare AKP-së, me të cilën është bashkangjitur Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Glllogoc C.nr.31/07, si dhe certifikatën pronësore për ngastrën Nr.00..-0. Tutje në këtë Propozim AKP-ja pohon se Gjykata Komunale në Glllogoc në seancën e mbajtur me datë 24 shtator 2007 lidhur me padinë nuk e ka ftuar, dhe nuk ka marrë pjesë përfaqësuesi ligjor i AKP-së në bazë të nenit 29 të Rregullores Nr.2005/18 për ndryshimin e Rregullores Nr.2002/12 mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, e cila dispozitë ishte në fuqi në kohën kur është mbajtur seanca gjyqësore. Tutje AKP-ja pohon se pasi që afati për ushtrimin e ankesës ka kaluar në afatin ligjor prej 30 ditësh, nga dita kur jemi njoftuar me Aktgjykimin në fjalë, e paraqesim këtë Propozim për përsëritje të procedurës, pasi që Aktgjykimi C.nr.31/07 i datës 24 shtator 2007 ka shkelur dispozitat procedurale. Tutje në këtë propozim AKP-ja pohon se kopja e padisë asnjëherë nuk i është dërguar dhe nuk i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në seancën e shqyrtimit kryesor për çështjen kryesore, andaj në bazë të nenit 232 paragrafi 1 nënpikat a) dhe b) të LPK-së, kërkohet të aprovohet Propozimi për përsëritje të procedurës, të anulohet Aktgjykimi i cekur i Gjykatës Komunale, dhe të lejohet përsëritja e procedurës, dhe dosja të dërgohet në Shkallën e I-rë të Gjykatës kompetente. Bashkë me këtë propozim e bashkëngjit një kopje të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Glllogoc, C.nr.31/07 të datës 24 shtator 2007, i cili ka klauzolën e plotfuqishmërisë me datë 26 shkurt 2008, një kopje të kërkesës për informata lidhur me ngastrën Nr.00.. ZK T, drejtuar Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe

Pronë, Glllogoc, kopjen e fletë posedimit Nr..., të datës.., një kopje të një akti përcjellës të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë dërguar AKP-së – Zyra Rajonale në Mitrovicë, një kopje të emalit zyrtar të datës 16 maj 2023, dhe certifikatën pronësore për ngastrën Nr.00..-0.

Me datë 16 gusht 2023, Kolegji i Apelit lëshoi një urdhër për Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, me të cilin ka kërkuar që në afat prej 5 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t'ia përcjellë në kompetencë të mëtejme dosjen e lëndës C.nr.31/07, të ish Gjykatës Komunale në Glllogoc.

Me datë 22 gusht 2023, Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc e dërgon në DHPGJS dosjen e lëndës C.nr.31/07.

Me datë 16 gusht 2023, Kolegji i Apelit lëshoi një urdhër për avokatin e të paditurit M K, me të cilën e ka dërguar Propozimin e AKP-së për përsëritje të procedurës, për të dhënë përgjigje në këtë propozim. Urdhri është pranuar me datë 18 gusht 2023.

Me datë 05 shtator 2023, i padituri M K nëpërmes Avokatit të tij, ka dorëzuar një parashtresë dhe përgjigjet në Propozimin e AKP-së për përsëritje të Procedurës. Në këtë parashtresë i padituri pohon se Propozimi i AKP-së për përsëritje të Procedurës, është paraqitur pas afatit, përkatësisht në kundërshtim me nenin 234 pika 1 nënpika a të LPK-së, andaj AKP-ja ka humbur afatin për paraqitjen e këtij propozimi. Tutje i padituri pohon se veprimi i tij ka qenë në bazë të dispozitave ligjore, duke iniciuar padi ndaj KB Glllogovci, duke kërkuar njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrën kadastrale nr. .., ndërsa në këtë rast i vetmi person që ka pas interes juridik ka qenë KB Glllogovci. Tutje ai pohon se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Glllogocë është bërë i fomës së prerë, dhe mbi bazën e këtij Aktgjykimi e ka regjistruar pronën lëndore në regjistrin kadastral në emër të tij. Paditësi në këtë parashtresë ka kërkuar që propozimi i AKP-së për përsëritje të procedurës, të hedhet poshtë si pa pranueshëm, pasi që është i pa afatshëm, ose

ai të refuzohet si i pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Glllogoc, C.nr.31/07 i datës 24.09.2007.

### **Arsyetimi ligjor:**

Propozimi i AKP-së për përsëritje të procedurës refuzohet si i pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Vlerësimi i Kolegjit të Apelit, lidhur me Propozimin e AKP-së për përsëritje të procedurës**

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja- Zyra Rajonale në Mitrovicë / Autoriteti i Likuidimit i NSH BQ "Drenica", në Glllogoc, me Propozimin për përsëritje të procedurës të dorëzuar në DHPGJS me datë 28 korrik 2023, kërkon nga kjo gjykatë që të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Glllogoc, C.nr.31/07, i datës 24 shtator 2007, i plotfuqishëm nga data 26 shkurt 2008, me arsyetimin që AKP-ja, nuk është ftuar nga gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor lidhur me padinë të mbajtur me datë 24 shtator 2007, dhe pretendon se ka bazë ligjore sipas nenit 232 paragrafi 1 nënpika a) dhe b) të LPK-së, që të lejohet përsëritja e procedurës.

Kolegji i Apelit vëren se në padinë e dorëzuar në DHPGJS me datë 05 tetor 2006, palë e paditur ishte Ndërmarrja Prodhuese Bujqësore Qarkulluese "Drenica", Glllogoc, në emër të së cilës ishte ngastra nr.00... Peditësit tashmë i është njohur e drejta e pronësisë për këtë ngastër, bazuar në parashkrimin fitues me Aktgjykimin e formës së prerë.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se në të gjitha seancat e mbajtura pranë Gjykatës Komunale në Glllogoc lidhur me këtë padi, ka marrë pjesë përfaqësuesi i NSH-së së paditur, e jo përfaqësuesi i AKP-së.

Kolegji i Apelit vëren se AKM-ja me datë 06 korrik 2006, e kishte pranuar një Njoftim nga përfaqësuesi i paditësit, me të cilën AKM-ja ishte njoftuar për padinë e paditësit të paraqitur në DHPGJS me datë 05 tetor 2006.

Kolegji i Apelit vëren se në këtë rast palë e paditur është NSH-ja e jo AKP-ja, pasi që prona lëndore e kërkuar nga paditësi ishte në emër e NSH-së. AKP-ja në bazë të Ligjit të AKP-së i administron asetet e NSH-ve dhe i përfaqëson NSH-të në procedura gjyqësore dhe ky fakt nuk është kontestues. AKP-ja në këtë rast është e qartë se nuk kishte mundësi të paraqitet me statusin e palës në procedurë, por kishte mundësi ligjore ta përfaqëson NSH-në. Fakti se përfaqësuesi i AKP-së nuk ka marrë pjesë në procedurën lidhur me padinë e paditësit, në kushte kur paraardhësja e saj AKM-ja ishte njoftuar për këtë padi, nuk mund ta bëjë në aspektin procedural Aktgjykimin e kësaj Gjykate të paligjshëm.

Është e qartë se ka një lëshim procedural që është bërë nga ish Gjykata Komunale në Glllogoc, kur në procedurë nuk është ftuar edhe përfaqësuesi i AKM-së, mirëpo ky lëshim i gjykatës nuk e legjitimon kërkesën e AKP-së që të anulohet Aktgjykimi i cekur që është i formës së prerë, dhe të lejohet përsëritja e procedurës.

Raporti në mes në NSH-së dhe AKM-së-AKP-së, është raport intern i tyre në të cilin ka përgjegjësi reciproke. Në këtë raport është përgjegjësi si e NSH-së dhe e AKP-së, që të koordinohen edhe lidhur me paditë që paraqiten ndaj tyre, dhe ta informojnë njëra tjetrën edhe për çështjen e përfaqësimit në gjykatë.

Në këtë rast nuk mund të konsiderohet se ish AKM-ja nuk ka qenë e njoftuar lidhur me padinë pronësore të paditësit, e po ashtu edhe i autorizuari NSH-së që e ka përfaqësuar NSH-në në gjykatë, ka pas përgjegjësi ligjore ta informon AKM-në për ftesën e pranuar nga gjykata. Dështimi në ushtrimin e përgjegjësive dhe mos koordinimi i duhur në mes NSH-së dhe AKM-së, është e qartë se në këtë rast ka ndodhë, por që evidente është edhe fakti se ka ndodhë edhe lëshimi i gjykatës së shkallës së parë.



Nga këto arsye, Kolegji i Apelit konsideron se në këtë rast nuk janë plotësuar kushtet sipas nenit 232 paragrafi 1 nënpika a) nënpika b) e LPK-së që të anulohet Aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Komunale në Glllogoc. Kjo për faktin se në këtë procedurë në shkallën e I-rë ka marrë pjesë pala e paditur, që në këtë rast është NSH-ja, ndërsa AKM-ja/AKP-ja nuk kishte mundësi me statusin e palës të paraqitet në procedurë. NSH-ja në emër së cilës ishte prona lëndore ishte e përfaqësuar nga i autorizuari i saj, në të gjitha seancat gjyqësore të mbajtura nga gjykata e shkallës së I-rë lidhur me padinë.

Është e qartë se i autorizuari i NSH-së, që ka marrë pjesë në procedurë e ka pasur rastin të dëgjohet dhe ti mbrojë interesat pronësore të NSH-së lidhur me ngastrën lëndore. I autorizuari i NSH-së e kishte pranuar edhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Glllogoc, me datë 30 tetor 2007, por që ai ka zgjedhur të mos bëjë ankesë në DHPGJS-së.

### **Zbatimi i parimit të sigurisë ligjore për palët e përfshira në procedurë**

Aktgjykimet dhe aktvendimet e formës së prerë të nxjerra para hyrjes në fuqi të nenit 4.5 e LDHP-së të vitit 2012, dhe të nenit 5.7 nënpika 7.1 i LDHP-së në zbatim, nuk duhet të konsiderohen nul dhe pa efekte juridike, edhe nëse janë nxjerrë për rastet që bien në kompetencë të Dhomës së Posaçme. Në këtë rast padia ishte e referuar nga DHPGJS-ja, dhe Gjykata Komunale në Glllogoc kishte të juridiksion të plotë lëndor të vendos për padinë.

Lidhur me pyetjen e vendimeve të nxjerra nga gjykatat jo kompetente, apo gjykatat kompetente, sistemet ligjore në përgjithësi përgjigjen duke u thirrur në parimin e sigurisë ligjore me vërtetim të plotfuqishmërisë së aktgjyimit (*'res judicata'*), që mbulon dhe rregullon të gjitha format e parregullsive të shkaktuara si pasojë e mungesës së juridiksionit apo ndonjë parregullsie tjetër procedurale që mund të jetë shkaktuar nga Gjykata përkatëse, që ka vendosur për rastin.

Edhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka inkorporuar këtë arsyetim në koncept të së drejtës për gjykim të drejtë. Në aktgjykimin e rastit të XHERAJ v. ALBANIA (Kërkesa nr. 37959), e datës 29.07.2008, thuhet si në vijim:

51. Gjykata rithekson se në përputhje me preambulën e Konventës, sundimi i ligjit është pjesë e trashëgimisë së përbashkët e Shteteve Kontraktuese, një nga aspektet themelore e së cilës është parimi i sigurisë juridike, që ndër të tjerash kërkon se kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, aktvendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje (shih *Brumărescu v. Rumania* [GC], nr. 28342/95, § 61, ECHR 1999 VII).

52. Për më tepër, Gjykata vëren se kushtet e sigurisë ligjore nuk janë absolute. Shmangia nga ky parim justifikohet vetëm nëse ka qenë e domosdoshme të bëhet si rezultat i rrethanave të një karakteri thelbësor dhe detyrues (Ryabykh k. Rusi, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003 IX), ose nëse vlerësimet serioze legjitime janë më të rëndësishme sesa parimi i sigurisë juridike (shih *Bratyakin v. Rusi* (dhjetor), nr. 72776/01, 9 mars 2006).

Dhe ne mund të gjejmë ritheksimin e kësaj deklarate në rastet e *Sovtransavto Holding v. Romani* (Kërkesa nr. 48553, 25.07.2002), *Androne v. Romani* (Kërkesa nr. 54062/00, 22.12.2004) dhe *SC Plastick ABC SA v. Ukrainë* (Kërkesa nr. 32299, 7.02.2008).

Në fakt Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht përcakton në nenin e saj 22 se të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, 'dhe në rast konflikti kanë prioritet ndaj dispozitave të ligjit'.

Shtrohet pyetja në rast se Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ose Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), mungon në procedurat gjyqësore, a e ndalon një

gjë e tillë Kolegjin e Apelit që ta konsiderojë aktgjykimin si të formës së prerë. Përgjigja ndaj kësaj pyetje është jo.

Agjencia (AKM-ja ose AKP-ja) sipas neneve 1, 2, 6 dhe 7 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, Ligjit 03/L-067, dhe Ligjit 04/L-033, është organ i pavarur publik me kompetenca për të administruar (që përfshin shitjen, transferimin dhe likuidimin) ndërmarrjet në pronësi shoqërore (NSH) apo asetet, por kompetencat e saj administrative nuk përjashtojnë autonominë, zotësinë juridike dhe menaxhimin e ndërmarrjeve nën administrimin e saj. Agjencia është e autorizuar që të ndërhyjë fuqishëm në menaxhimin e NSH-së, por nuk e zëvendëson atë; nuk e inkorporon atë. Ato megjithatë, janë subjekte të ndryshme autonome, edhe pse brenda vetes janë të ndërlidhura.

Në fakt ligji përcakton një sërë dispozitash për të siguruar që Agjencia të jetë në dijeni për çështjet gjyqësore në të cilat është e përfshirë NSH-ja; domosdoshmërinë e njoftimit paraprak lidhur me qëllimin e ushtrimit të ndonjë veprimi juridik (neni 29 i ligjit për AMK-në/ AKP-në), pa e diskutuar tani nëse kjo dispozitë mbetet pas 01.10.2012 me hyrjen në fuqi të Ligjit për Dhomën e Posaçme); nga gjykata kërkohet që të emërojë Agjencinë si palë (sipas nenit 5.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme). Mirëpo bërja me dije vetëm ia jep mundësinë Agjencisë që të mos e zëvendësojë por "të veprojë në emër të saj" (shih nenin 6.2.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe nenin 29.2 të Ligjit për AKP-në) si "përfaqësues ligjor" (shih nenin 29.3 të Ligjit për AKP-në) i NSH-së.

Si rrjedhojë, raporti midis NSH-së dhe Agjencisë duhet të konsiderohet si i brendshëm. Agjencia dhe NSH-ja janë dy anët e së njëjtës monedhë.

Prandaj, pjesëmarrja e njërës prej tyre në procedura gjyqësore, është e mjaftueshme që të merret parasysh në përputhje me të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për gjykim të drejtë.

Mungesa e Agjencisë për të intervenuar nuk e vë në dyshim plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Aktgjykimi i plotfuqishëm për rastin kur vetëm NSH-ja, ose Agjencia kanë qenë palë, është aktgjykim detyrues për të dyja, si për NSH-në ashtu edhe për Agjencinë. Ky ka qenë edhe konkluzioni i gjykatës në disa aktgjykime tjera, që do të thotë në aktgjykimet e datave 20.09.2012 (rasti SCPL-10-0001), 7.03.2013 (rasti AC-II-12-0212) dhe 28.06.2013 (rastet SCA-08-0040 dhe SCA-08-0038).

Prandaj duke u bazuar në arsyet e cekura, më lartë dhe qëndrimet parimore juridike të Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, që i referohen parimit të sigurisë ligjore të palëve në procedurë, Kolegji i Apelit konsideron se në këtë rast, nuk ka bazë ligjore nga neni 232 par.1 nënpika a) dhe nënpika b) e LPK-së, që të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Glllogoc, C.nr.31/07 i datës 24 shtator 2007, i plotfuqishëm nga data 26 shkurt 2008, dhe as që ka bazë ligjore që të lejohet përsëritja e procedurës të përfunduar me Aktgjykim të formës së prerë.

Prandaj nga këto arsye, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e AKP-së për përsëritjen e procedurës gjyqësore të paraqitur ndaj Aktgjykimit në fjalë.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën sipas Propozimit për përsëritje të procedurës, në shumë prej 100 euro, me datë 09 gusht 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_